




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Qeveria - Vlada - Government
Komuna/ Opstina/ Municipality Drenas (Glllogoc)
Zyra e Kryetarit
Nr. 01-DSD/01-15178 Dt. 07. 05. 2020

KOMUNA E DRENASIT

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve dhe personave fizik për fushën e kulturës, rinisë dhe sportit

1. Komuna e Drenasit u bënë thirrje të gjitha organizatat joqeveritare (OJQ), të regjistruara dhe programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, si dhe personave fizik, të aplikojnë për mbështetjen financiare për zbatimin e projektit të promovimit dhe zhvillimit të kulturës, sportit dhe edukimit të rinisë.

2. OJQ-të dhe personat fizik në përputhje me këtë Thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për aktivitetet e mëposhtme, por duke mos u kufizuar vetëm në këtë:

- Klubet sportive (pagesa e regjistrimit të klubeve në Federatat përkatëse, e kuotizimit, referimit, transportit dhe të ushqimit për ndeshjet zyrtare etj)
- Sportistët e dalluar
- Garat sportive
- Shoqëritë amatore (ansamblet)
- Teatrot amatore
- Festivalet
- Botimi i librave/shkrimeve letrare
- Ekspozitat me fotografi
- Aktivitete me karaktere garuese
- Pjesëmarrje në festivale jashtë komune
- Promovim i librave
- Promovim i talenteve të rijs

3. OJQ-ja ose individi mund të paraqesë vetëm një projekt në kuadër të kulturës dhe një projekt të veçantë në kuadër të rinisë dhe sportit, i cili do të përfshijë dhe kontribuojë në promovimin e aktivitetit të paraparë me pikën 2 të kësaj Thirrjeje publike. Nuk mund të paraqitet një projekt i cili do të përmbajë aktivitetet nga të dy fushat, por ekskluzivisht ndaras për secilën fushë.

4. Vlera e përgjithshme e planifikuar e Thirrjes publike është 79,000.00€ (shtatëdhjetë e nëntë mijë euro), nga e cila për:

- Kulturën – 11,000.00€

- Rininë – 3,000.00€
- Sportin 65,000.00€

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 300.00€, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 40,000.00€.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimit është 15 ditë pune nga dita e publikimit të Thirrjes publike, përkatësisht dita e fillimit është 07.05.2020, ndërsa dita e fundit për dorëzimin e propozimit është 29.05.2020.

6. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare të R.Kosovës, me seli në territorin e Komunës së Drenasit dhe të cilat veprojnë dhe janë të regjistruara së paku një vit para datës së publikimit të Thirrjes publike, si dhe personat fizik banorë të Komunës së Drenasit.

OJQ-ja aplikuese duhet të paraqesë dëshmi se gjatë një viti është marrë me organizimin e ngjarjeve kulturore ose sportive, si dhe nëse ka qenë përfutuese e mjeteve financiare të ndara nga Komuna e Drenasit, të njëjtat mjetet i ka justifikuar duke paraqitur raportin financiar.

Pas nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në kuadër të formularit të paraparë, të cilin së bashku me Udhëzimet për aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të *Komunës së Drenasit*- kk.rks-gov.net/drenas. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht në zarf të mbyllur, në adresën e mëposhtme: Komuna Drenas, rrugu “Xhevë dhe Fehmi Lladrovci” 13000.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, resurset, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimin për aplikuesit.

Do të konsiderohen vetëm propozimet që janë paraqitur brenda afatit për paraqitjen e aplikacioneve dhe në formë të përcaktuar me Thirrjen publike.



 Ramiz Lladrovci